



KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, më 19.2.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik Darjel Sina, në seancën publike të datës 19.2.2019, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Çështja objekt shqyrtimi, ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari, prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues!

Pasi u njohëm me prapësimet dhe aktet e dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 13.2.2019, Komisioneri Publik konstaton se:

I. Lidhur me burimin e ligjshëm për 1/3 e pasurisë tokë-arë me sip. 350 m² dhe shtëpi banimi (4 kate), ndodhur në Tiranë

- *Për të ardhurat e deklaruara të përfituara nga emigracioni* i personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 1997-2000, aktet e dorëzuara nga subjekti janë po ato të administruara në fashikullin e Komisionit.

- *Edhe për shumën 12.000 euro*, deklaruar si e ardhur nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit, në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në vitin 2003, paguar nga shoqëria shqiptare “****” sh.p.k., aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit janë po ato të administruara në fashikullin e Komisionit, fakt i cili i bën ato të panevojshme.

Në vlerësim të Komisionerit Publik rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion provues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, detyrim ky që rrjedh nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 32/1, i ligjit nr. 84/2016. Subjekti i ka deklaruar këto të ardhura, por nuk provon nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, me qëllim konsiderimin e tyre si të ardhura të ligjshme.

II. Lidhur me të ardhurat nga puna e personit të lidhur në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në shumën 18.970 USD, deklaruar në deklaratën vjetore për vitin 2006

Sipas parashtrimeve, subjekti, mbështetur në analizën që i bën legjislacionit tatimor të zbatueshëm, arrin në konkluzionin se kjo e ardhur është krijuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, si e tillë, ajo i është nënshtruar rregullave të legjislacionit tatimor të vendit ku është krijuar, si dhe në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi në vitin 2006, nuk ka qenë detyrim deklarimi pranë organeve tatimore, për qëllim tatimi.

Përkundër këtij arsytimi, i cili në vlerësim të Komisionerit Publik është i gabuar, referuar legjislacionit tatimor në fuqi në vitin 2006, të gjitha burimet e të ardhurave i nënshtroheshin detyrimit për tatim, duke përcaktuar kështu dhe të ardhurat që përjashtoheshin, e në të cilat nuk

përfshihen të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret.

Referuar nenit 7 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave. Po ashtu, neni 17 i këtij ligji përcakton se tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas nenit 8 të këtij ligji, si dhe udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, në të ardhurat e tatueshme për qëllim të tatimit përfshihen pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me të ardhurat nga punësimi. Në këtë kategori të ardhurash përfshihet si paga, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë, që lidhen me punësimin e individit. Pika 2.2 e këtij udhëzimi përcaktonte se në nenin 7 të ligjit “Shtrirja e detyrimit” jepet parimi i përgjithshëm, sipas të cilit individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të ardhurat me burim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për qëllim të këtij udhëzimi, në vitin 2006 ka qenë i miratuar dhe formati dhe të dhënat e deklaratës së tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, që dorëzohej pranë administratës tatimore për periudhën e deklarimit tatimor, ku përveç të ardhurave nga dhënia me qira, të ardhurat nga huat, të ardhurat nga pronësia intelektuale dhe të drejtat e autorit, përfshiheshin dhe të ardhurat me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat tatoheshin 10%.

Sa më sipër, nëse këto të ardhura i janë nënshtuar rregullave të legjislacionit tatimor të vendit ku janë krijuar, sikurse pretendon dhe subjekti, nuk rezulton të jetë dorëzuar asnjë dokumentacion provues mbi këtë fakt.

Në vlerësim të Komisionerit Publik, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arrijnë të provojnë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, detyrim ky që rrjedh nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

III. Lidhur me të ardhurat e deklaruara të personit të lidhur/bashkëshortit nga veprimtaria e biznesit në vitin 2010, në shumën 3.171.510 lekë

Konstatohet se subjekti ka paraqitur disa dokumente shpesh dhe nga verifikimi i tyre, krahasuar me dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit, vërejmë mospërputhje si në rend kronologjik të informacionit të dërguar nga administrata tatimore, ashtu edhe për vlerën e paguar si detyrim tatimor.

Konkretisht, ILDKPKI-së, administrata tatimore, më datë ***.8.2017, i ka dërguar informacion për mungesë aktiviteti të vitit ushtrimor 2010 (NIPT ***), ndërkohë sipas akteve të sjella nga vetë subjekti, pagesa e tatimit rezulton e paguar nëpërmjet Bankës, më datë ***.3.2011, ndërkohë që pasqyrat financiare të vitit 2010 janë depozituar nga ana e subjektit tatimpagues, në vitin 2016.

Pra, dhe në rend kronologjik, nëse të dhënat kanë rezultuar të ngecura dhe nuk kanë qenë të shfaqura normalisht në sistem në vitin 2011, me depozitimin e bilancit në vitin 2016, nga ana e subjektit tatimpagues, kjo mangësi do të ishte rikuperuar dhe informacioni i dërguar

ILDKPKI-së do të ishte i plotë dhe i saktë, duke përfshirë dhe të ardhurat nga aktiviteti edhe të vitit 2010.

Ndërsa lidhur me vlerën e paguar si detyrim tatimor¹, asnjë nga shumat nuk përputhet me masën e tatimit 10%, që është deklaruar në administratën tatimore sipas fitimit të deklaruar.

Mbetet e pavërtetuar që subjekti tatimpagues, me NIPT ***², ka kryer pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën gusht - dhjetor 2010, për aktivitetin e kryer. Po ashtu, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2017, drejtuar Komisionit, shprehet se nuk janë përfshirë të ardhurat nga biznesi për vitin 2010, në shumën 3.171.510 lekë.

IV. Për të ardhurat e deklaruara nga veprimtaria ekonomike e personit të lidhur për vitin 2016, në shumën 3.299.805 lekë

Për sa i përket pagesës së tatimeve apo detyrimeve të prapambetura të subjektit tatimpagues, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur një dokument të printuar “*në kohë reale*”, i datës ***.10.2018, ku rezulton se nuk ka detyrime tatimore. Gjithsesi konstatohet se mbetet e paprovuar nëse janë paguar detyrimet ndaj Drejtorisë së Taksave të Bashkisë, pasi, bazuar në përgjigjet e Bashkisë Tiranë, shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2017, drejtuar Komisionit, konfirmohet se subjekti tatimpagues, z. ***.*** nuk ka shlyer asnjë detyrim ndaj Bashkisë Tiranë.

V. Lidhur me denoncimin e depozituar pranë KPA-së

Referuar nenit Ç, pika 2, paragrafi i dytë i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, këto dispozita lejojnë marrjen e informacioneve nga ana e publikut, të cilat kanë vlerë për procesin e rivlerësimit. Në këtë rast, vlerësimi dhe kontrolli i informacionit për këtë qëllim i njihet KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Në këto kushte, për denoncimin e paraqitur nga shtetasi ***.***, sikurse dhe për denoncimet e tjera, e lëmë në çmimin Tuaj vlerësimin dhe gjykimin e tyre.

Komisioneri Publik vlerëson se informacioni i përcjellë përmes këtyre denoncimeve përmban elementet e parashikuara në nenin 53/2 të ligjit nr. 84/2016, që mund të drejtojnë në një vlerësim të kundërt lidhur me aftësitë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Darjel SINA

Komisioner Publik

¹ Sipas të dhënave të ardhura nga administrata tatimore, fitimi para tatimit është 3.506.533 dhe tatim-fitimi i llogaritur në masën 10% duhet të ishte 350.653 lekë. Ndërsa sipas: urdhërpagesës së *** Bank është konfirmuar shuma 335,023 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e njëzet e tre) lekë.

Në shkresën e tatimeve drejtuar subjektit tatimpagues ***.*** rezulton e konfirmuar nga kontabiliteti shuma 335,148 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë.

Pasqyrat financiare të vitit 2010, të dorëzuara në vitin 2016, tregojnë tatim-fitimi në shumën 333,834 (treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë.

² Sipas shkresës së Drejtorisë së Vlerësimit të të ardhurave tatimore në DRRT, shkresa nr. *** prot., datë ***.11.2016.